



Në bazë të nenit 8, nenit 10 pika 2.3 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 dhe nenit 15 të Rregullores për Marrëdhënien e Punës nr. 01-2978/22, të dt. 27.06.2022, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 01-2978/22, të dt. 28.03.2023, Telekom i Kosovës Sh.A. shpall:

KONKURS PUBLIK

Për Punë dhe Detyra Specifike

Titulli i punës: **Ekspert për Menaxhimin dhe Koordinimin e Transmetimit të Ngjarjeve Sportive**

Mandati: **5 muaj**

Ekzekutues: **1**

Vendi: **Prishtinë**

Ndërmarrja: **Telekomi i Kosovës Sh.A**

Grada: **D-13**

Afati i fundit për aplikim: **05.03.2026**

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Koordinimin ndërmjet Telekomit të Kosovës dhe RTK-së për projektin e transmetimit të Kampionatit Botëror.
- Menaxhimin e marrëdhënieve me FIFA-n dhe palët relevante për këtë projekt.
- Drejtimin dhe mbikëqyrjen e prodhimit të transmetimit, përfshirë prodhimin për kanalet Valasport.
- Kryerjen e detyrave të tjera të nevojshme që lidhen me organizimin dhe realizimin e projektit të transmetimit të Kampionatit Botëror të Futbollit, sipas kërkesave të Telekomit të Kosovës.
- Koordinimin e aktiviteteve ndërmjet Telekomit të Kosovës dhe RTK-së lidhur me transmetimin e ngjarjeve sportive ndërkombëtare.
- Ndihmën në procesin e prodhimit dhe transmetimit të ndeshjeve, përfshirë prodhimin për kanalet Valasport.
- Sigurimin e respektimit të standardeve teknike, editoriale dhe operacionale të përcaktuara nga FIFA dhe marrëveshjet kontraktuale.
- Kryerjen e detyrave të tjera të ndërlidhura me organizimin dhe realizimin e projektit, sipas kërkesave të Telekomit të Kosovës.

Kushtet dhe kriteret që: **Eksperti për Menaxhimin dhe Koordinimin e Transmetimit të Ngjarjeve Sportive** duhet t'i plotësojë:

- Diplomë universitare.
- Përvojë e dëshmuar profesionale në menaxhimin dhe/ose prodhimin e transmetimeve sportive ndërkombëtare.
- Përvojë në bashkëpunim me transmetues publikë dhe privat.
- Njohuri të standardeve ndërkombëtare të transmetimit sportiv.
- Aftësi të shkëlqyera koordinimi, komunikimi dhe menaxhimi projektesh.
- Aftësi teknike dhe prodhuese.
- Njohuri për teknologjitë e transmetimit, përfshirë OTT, satelit, IP streaming dhe prodhim në terren.
- Njohuri të gjuhës angleze në nivel të avancuar (me shkrim dhe me gojë).

Forma e angazhimit

- Angazhim me kontratë të përkohshme, për kohëzgjatjen e projektit.
- Raporton drejtpërdrejt të menaxhmenti përgjegjës i Telekomit të Kosovës.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Kërkesa për punësim/Aplikacioni (që mund të merret edhe online në: www.kosovotelecom.com)
- CV e detajuar
- Letra motivuese
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmitë e kualifikimit (diploma, certifikata, etj.)
- Certifikata e nxjerrë nga gjykata kompetente që vërteton se aplikanti nuk është nën hetime (jo më të vjetër se 6 muaj).

Dokumentacioni i lartcekur duhet të dorëzohet personalisht në zarf të mbyllur në zyrën e arkivit qendror në katin e VI, zyra nr.603, ndërtesa kryesore e TK Sh.A Dardania p.n.10000 Prishtinë, Republika e Kosovës ose në e-mail adresën hr@kosovotelecom.com

Kandidatët me dokumentacion të mangët, të paplotësuar dhe joadekuat do të refuzohen.

Për kualifikimin e kandidatëve dhe rezultatet e arritura në këtë proces të përzgjedhjes, kandidatët do të njoftohen me kohë përmes e-mailit zyrtar hr@kosovotelecom.com brenda afateve të parapara ligjore.